



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2019:076238

Datë: 17.06.2019

Numri i dokumentit: 00362116

P.nr.168/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me procesmbajtësen Donika Latifi, në çështjen penale kundër të pandehurit H. K. nga Gjilani, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 paragrafi 2 i KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.247/2019, të datës 15.02.2019, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datën 12.06.2019, mori këtë:

AKTVENDIM

- I. HUDHET poshtë aktakauza e Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.247/2019, të datës 15.02.2019 dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit H. K. nga Gjilani, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 paragrafi 2 i KPRK-ës, për arsye se prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar është tërhequr nga aktakuza.
- II. Aktakuza e tërhequr nuk mund të ushtrohet përsëri nga prokurori i shtetit.
- III. Shpenzimet e procedurës penale paguhet nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 19.02.2019, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.247/2019, kundër të pandehurit H. K. nga Gjilani, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 paragrafi 2 i KPRK-ës.

Me datë 12.06.2019, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit dhe i pandehuri H. K. ndërsa kishte munguar i dëmtuari Z. M. i cili në seancën e datës 21.05.2019, kishte deklaruar se dëshiron të tërhiqet nga ndjekja penale ndaj të pandehurit H. meqenëse të njëjtit i kanë rregulluar raporte në mes tyre dhe se ky rasti kishte ndodhur aty për aty, nuk kanë pasur më probleme me të njëjtin as më herët e as pas rastit të ndodhur. Duke pasur parasysh se vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri i lartcekur është vepër penale e cila ndiqet sipa propozimit të të dëmtuarit si dhe duke pasur parasysh edhe deklarin e të dëmtuarit Z. M., gjykata në seancën e shqyrtimit fillestar ka kërkuar nga prokurori i shtetit që të deklarohet lidhur me këtë çështje, me çrast prokurori i shtetit ka deklaruar se meqenëse vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri ndiqet sipas propozimit të palës së dëmtuar dhe në këtë rast pala e dëmtuar është tërhequr nga ndjekja penale edhe prokurori i shtetit tërhiqet nga aktakuza e ushtruar ndaj të pandehurit H. K..

Meqenëse prokurori i shteti ishte tërhequr nga ndjekja penale, gjykata në bazë të nenit 292 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së, mori aktvendim me të cilin hodhi poshtë aktakuzën dhe pushoi procedurën penale ndaj të pandehurit H. K. nga Gjilani, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 paragrafi 2 i KPRK-ës.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.168/2019, më datë 12.06.2019

Procesmbajtësja  
Donika Latifii

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermaxhaj

**KËSHILLA JURIDIKE:**Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve nga dita e pranimi të aktvendimit. Ankesa ushtrohet nëpërmes kësaj gjykate.